



Datë: 18.02.2025
Numër protokoll: 2233/2025

A.nr.2055/2024

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2055/2024, të datës 19.12.2024, të parashtruar nga ankuesi I.E., kundër organit të punësimit: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2055/2024, e datës 19.12.2024, e parashtruar nga ankuesi I.E.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi më numër protokoll 5984/03, i datës 21.11.2024, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, lidhur me shpalljen e kandidateve të suksesshëm, në procedurën e pranimi më numër reference RN00015204, pozita e punës Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Metrologjisë.

A r s y e t i m

Ankuesi I.E. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 19.12.2024, përmes adresës elektronike ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015204, për pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Metrologjisë, të shpallur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.01.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 6934/2024 të parashtruar më datë 19.12.2024 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ligjin Nr.06/L-037 për Metrologji; Udhëzimin Administrativ (MTI)-Nr.4/2020 për Mbikëqyrjen Metrologjike; Njoftimin e datës

03.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 15.01.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Konkursin me numër reference RN00015204 të datës 19.09.2024; Lista e aplikantëve (*refuzuar dhe aprovuar*); Vendimin për Themelimin e Komisionit të Pranimi Nr.03/229 të datës 05.11.2024; Vendimin me Ref:02/Nr.189 të datës 30.07.2024; Njoftimin për test me shkrim të datës 11.11.2024; Formularët e anëtarëve të Komisionit të Emërimit në Kategorinë e Lartë Drejtuese për Vlerësimin Individual të Kandidatëve për Intervistë të datës 20.11.2024; Aplikacionin e ankuesit I.E. me datë të aplikimit 15.10.2024 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidatit A.J me datë aplikimi 27.09.2024 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionin e kandidates S.B-I me datë aplikimi 16.10.2024 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimi me numër protokoli 599/2025 i Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 19.09.2024 ka shpallë konkursin publik për pranim me numër reference RN00015204, për pozitën e punës “*Drejtor Ekzekutiv*” në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, me klasë të pozitës Drejtues i Lartë, me mandat katër (4) vjeçar, i hapur për aplikim nga 20.09.2024 deri më 19.10.2024.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë shtatë (7) kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe i njëjti i është nënshtruar vlerësimit profesional, ashtu që, në testin me shkrim ka arrit 25 pikë, ndërsa në intervistën me gojë 34.4 pikë, gjithsejtë 59.4 pikë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, më datë 21.11.2024 ka publikuar Njoftimin për renditjen përfundimtare të kandidateve me numër protokoli 5984/03, nga i cili njoftim rezulton se si kandidate e suksesshme për procedurën përkatëse të rekrutimit janë shpallur S.B.I. me 86.4 pikë dhe A.J., më 77.2 pikë.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të: shkeljes së procedurave të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe shkeljeve të procedurave të përcaktuara me Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil. Shton se testi nuk ka qenë i përgatitur mirë, pasi që ka pas pyetje ku tre opsionet e përgjigjes kanë qenë të pasakta, nuk kanë qenë të artikuluar sipas përkufizimeve në legjislacionin përkatës, ka pas diskriminim dhe trajtim jo të barabartë sepse në konkursin e vitit 2021 është poentuar me 71.78 pikë, ndërsa në konkursin aktual me 34.4 pikë.

Kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe që konkursi i shpallur nga organi përkatës i punësimit të jetë në përputhje me ligjin dhe rregulloret e aplikueshme.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit publik me numër reference RN00015204, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i**

kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Fakulteti Teknik (Inxhinieri Mekanike Elektrike), Shkenca të natyrës (Kimi, Fizik); **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë njërën nga kërkesat në vijmë: pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese, katër (4) vite përvojë pune në pozita drejtuese dhe diplomë e nivelit të dytë të arsimit të lartë (master), ose tre (3) vite përvojë pune në pozitë drejtuese dhe diplomë e nivelit të tretë të arsimit të lartë (doktoraturës) dhe si rrjedhojë Kolegji vlerësoj se kriteret e përgjithshme për pozitën përkatëse të punës kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ju referuar legjislacionit në fuqi, konkretisht Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë nenit 47 ku përcaktohet se: “

1. Pranimi në pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publik të organizuar për çdo pozitë të lirë. 2. Procedura e rekrutimit organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga njësia përgjegjëse, për çdo institucion tjetër shtetëror. 3. Shpallja e procedurës së rekrutimit bëhet nga njësia përgjegjëse, në SIMBNj, në ueb faqen e institucionit përkatës, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 4. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatet/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimi për pozitë të kategorisë së lartë drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrenteve/ëve si dhe intervistë me gojë. 8. Të gjithë kandidatet/ët e vlerësuar nga komisioni i pranimi mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidate/at fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. 9. Lista e kandidateve/ëve fitues i dërgohet mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë dhe bëhet publike nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme informimi. 10. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative. 11. Në rast se procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidate/at fitues të vlerësuar mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet procedurë e re rekrutimi.

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor si me sipër, si dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës Kolegji ka gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore lidhur me testimin me shkrim, për faktin që nga analizimi i përmbajtjes së testit me shkrim i aplikuar në këtë procedurë, Kolegji ka vërtetuar se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për të gjithë kandidatët, testi ka përmbajt 25 pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseje, pra, testi me shkrim ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, në kontekst të pretendimit ankimor se pyetjet e testit me shkrim kanë qenë me përgjigje të pasakta, Kolegji konsideron se një pretendim i tillë është i përgjithësuar, duke mos specifikuar se cila apo cilat pyetje të testit kanë qenë me përgjigje të pasakta, ndërsa, referuar pretendimit se pyetjet kanë qenë të pa artikuluar mirë dhe jo të përkufizuara në pajtim me legjislacionin përkatës, konkretisht termi i përdorur “Inspektim Meteorologjik”, sipas ankuesit nuk e njeh ligji për metrologjinë, e në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit pa u lëshuar në vartësinë e termi të përdorur, nga analizimi i testit me shkrim të ankuesit ka gjetur se pyetja me renditje nr. 11 ka qenë “Cili është inspektimi meteorologjik”, ndërsa, përgjigjet e parashtruara kanë qenë: 1. Audit i materiale industriale” 2. Kontroll për të verifikuar pastërtinë dhe përputhshmërinë e punimeve, 3. Testim i masës”, Rrjedhimisht, ankuesi ka dhënë përgjigje të saktë sipas çelësit të testit dhe i

njëjti është vlerësuar më 1 pikë, kështu që, ankuesi nuk është dëmtuar në asnjë rrethanë në kuptim të vlerësimit të drejtë lidhur me pyetjen përkatës.

Përkitazi më pretendimin ankimor së ka pas diskriminim dhe trajtim jo të barabarte të ankuesit, sepse, në konkursin e vitit 2021 ishte poentuar me 71.78 pikë, ndërsa, në konkursin aktual është poentuar me 34.4 pikë, Kolegji vlerëson se një pretendim i tillë i ankuesit nuk ka mbështetje, mbi arsyet së nuk kemi bëjmë me rrethana të njëjta, pasi që, testi nuk ka mundur të jetë i njëjtë në të dy procedurat dhe se Komisioni i Pranimit nuk ka mundur të jetë i njëjti.

Në kuptim të respektimit të parimit të meritokracisë si një nga parimet bazë në procedurë të pranimit në shërbim civil, Kolegji ka analizuar dosjet e kandidatëve fitues në këtë procedurë, nga dhe ka gjetur ketë gjendje të fakteve:

- **Kandidatja S.I.** posedon: Diplomën Nr.8, (datë 10.11.2005), për përfundimin e studimeve themelore (datë 12.03.2005) në Universitetin e Prishtinës Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyror, Diplomën me Nr.196, të datës 26.10.2011, për përfundimin e studimeve master në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, (datë 13.07.2011) në Universitetin e Prishtinës, ku ka marrë titullin Master e Shkencave të Kimisë, ndërsa, përkitazi me kriterin e përvojës së punës pas diplomimit ka bashkangjitur Vendimin me numër protokollit 1-4781/01 të datës 03.05.2024 të lëshuar nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me të cilin caktohet Ushtruese e Detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Vendimin me referencë Nr.01/05 të datës 10.02.2023, të lëshuar nga Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me të cilin caktohet zëvendësuese e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 08.06.2018 me të cilin dëshmohet se ka qenë e emëruar në pozitën “Udhëheqëse e Sektorit për Metale të Çmuara”; Akt emërimin e datës 02.10.2011, me të cilin ka qenë e emëruar si Zyrtare e Metrologjisë për Metale të Çmuara, në Departamentin e Metrologjisë, Vërtetimin e datës 16.01.2006 të lëshuar nga Laboratori Shëndeti në Prizren me të cilin dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune pranë këtij laboratorit nga data 03.01.2003 deri më datën 31.12.2005; Kontratën e punës me numër të kontratës 434/03 të datës 05.10.2006 të lëshuar nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes/ Departamenti i Administratës së Përgjithshme me të cilin dëshmohet se ka mbajtur pozitën e punës Zyrtare e Metrologjisë për metale të çmueshme në Prizren nga data 02.10.2006 deri më datën 01.10.2007, Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të kontratës 698/08 të datës 04.08.2008, me të cilin ka mbajtur pozitën Zyrtare e metrologjisë për metale të çmuara, nga data 31.07.2008 deri më datën 01.10.2011.
- **Kandidati A.J.** ka ofruar si dëshmi: Diplomën me numër Nr.85 të datës 10.03.2003, për përfundimin e studimeve themelore më datën 06.03.2003, në Fakultetin e Makinerisë, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, duke marrë titullin Inxhinier i Diplomuar, ndërsa, përkitazi me përvojën e punës ka bashkangjitur Vërtetimin me numër protokollit Nr.02/15 të datës 14.01.2015, të lëshuar nga Drejtori i Qendrës Edukative Don Bosko në Prishtinë, me të cilin vërtetohet se kandidati A.J ka qenë i angazhuar si Profesor nga data 01.01.2009 deri më datën 31.05.2014; Akt emërimin e datës 05.06.2014 me të cilin ka qenë i emëruar si Zyrtar në Laboratorin e Masës, Rrjedhës dhe Vëllimit, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të datës 02.12.2019 me të cilin ka qenë i emëruar si Udhëheqës në Laboratorin e Forcës dhe Presionit, në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, si Vendimin me numër reference Nr.01/30 si dhe numër protokollit 1-500/01 të datës 08.05.2024 me të cilin është emëruar si Ushtrues Detyre i Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ku të njëjtën e ushtron ende.

Andaj, nisur nga kjo gjendje e fakteve rezulton se kandidatja S.B.I. dhe A.J., kanë plotësuar kriteret e përgjithshme formale të përcaktuar me konkurs, e duke qenë së të njëjtit në fazën e vlerësimit kanë arritur pikat e nevojshme për tu konsideruar konkandidate fitues, kështu që, edhe njësia përgjegjëse në këtë rast Divizioni i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e ka vepruar pajtim me nenin 16 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Referuar të gjeturave dhe konstatimeve si më lart, dhe meqenëse nuk është të evidentuar ndonjë shkelje e natyre procedurale dhe materiale, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së procedura e pranimi për pozitën e punës *Drejtor Ekzekutiv*, në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që, thënë si me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.2055/2024

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, I.E.;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.